



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr. 1032/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Kymete Kicaj dhe Adnan Konushevci, anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Marigona Nuza, kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjakovës nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Gjakovë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.11.2021, mori këtë:

#### **V E N D I M**

**REFUZOHET** i pabazuar apeli Anr.1032/2021 i datës 04.11.2021 i parashtruar nga kandidatja për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjakovës Marigona Nuza, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Gjakovë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilin ka kërkuar rinumërimin e votave.

#### **A r s y e t i m**

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidatja për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjakovës Marigona Nuza nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Gjakovë, në të cilën thekson se ka keqpërdorim të votave për të në vendvotimet, 0225C në Molliq, 0221C shkolla fillore Dy Dëshmoret, 0214C shkolla fillore Ukshin Miftari, 0210C shkolla fillore Ganimete Tërbeshi, vendvotimi 0202X/016R. Andaj e njëjta kërkon rinumërim të votave.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

## Apeli është i pabazuar

Paneli, vlerëson se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të saja, nuk ka ofruar ndonjë provë bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mungesë të votave, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur mungesë të votave për kandidaten në fjalë, për faktin se thëniet e saja janë vetëm supozime dhe sipërfaqësore dhe jo të konkretizuara me asnjë provë konkrete bindëse për të cilën ajo pretendon në mos numërimin e votave por në vendvotimet e pretenduara nga ankuesja e ka specifikuar një person me emër dhe mbiemër dhe atë vendvotim qëndron një e me tepër vota ndërsa për te tjerat ka përmendur vetëm qendrat e votimit pa i specifikuar vendvotimet konkrete.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Marigona Nuza nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Gjakovë, nuk është i bazuar me asnjë provë apo dëshmi ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje apo parregullsi në vota për vendvotimet e lartcekura.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.1032/2021 më datën 07.11.2021



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.